V E N D I M
Nr. 235, datë 22.5.1999

PËR RRITJEN E PAGAVE TË GJYQTARËVE, NDIHMËSGJYQTARËVE EFEKTIVË DHE PROKURORËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 7800, datë 2.3.1994 "Për pagat e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve efektivë dhe prokurorëve", ndryshuar me ligjin nr. 8082, datë 7.3.1996, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pagat e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve efektivë dhe prokurorëve, rriten 10 për qind, sipas tabelave, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Ky vendim i shtrin efektet financiare nga data 1.5.1999.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

PASQYRA NR.1

1. PAGA MUJORE E ANËTARËVE TË GJYKATËS SË LARTË

1.1. Kryetar	83 600 lekë
1.2. Anëtar	79 400 lekë

PASQYRA NR. 2

2. PAGA MUJORE E PUNONJËSVE TË PROKURORIVE

2.1. Në Prokurorinë e Përgjithshme

1. Prokurori i Përgjithshëm	83 600 lekë
2. Prokuror i Gjykatës së Lartë	62 700 lekë
3. Prokuror (drejtor drejtorie)	50 330 lekë
4. Prokurorë të Prokurorisë së Përgjithshme	47 850 lekë

2.2. Në Prokurorinë e Apelit

1. Prokuror apeli	50 330 lekë
2. Zëvendësprokuror apeli	47 850 lekë
3. Prokuror	42 900 lekë

2.3. Në Prokurorinë e rrethit Tiranë

1. Prokuror rrethi	47 850 lekë
2. Zëvendës Prokuror rrethi	42 900 lekë
3. Prokuror	39 600 lekë
4. Oficer i policisë gjyqësore	34 320 lekë

2.4. Në Prokurorinë e rretheve

1. Prokuror rrethi	42 900 lekë
2. Zëvendës Prokuror rrethi	39 600 lekë
3. Prokuror	36 300 lekë
4. Oficer i policisë gjyqësore	34 100 lekë

PASQYRA NR. 3

3. PAGA MUJORE E GJYQTARËVE

3.1. Në gjykatën e Apelit Civil dhe në Gjykatën Ushtarake të Apelit

1. Kryetar	62 700 lekë
2. Zëvëndëskryetar	52 580 lekë
3. Gjyqtarë	49 500 lekë

3.2. Në gjykatën e rrethit Tiranë

1. Kryetar	49 500 lekë
2. Zëvendëskryetar	43 730 lekë
3. Gjyqtarë	40 430 lekë

3.3. Në gjykatat e rretheve

1. Kryetar	43 730 lekë
2. Zëvendëskryetar	40 430 lekë
3. Gjyqtarë	37 950 lekë

3.4. Ndihmësgjyqtar efektiv pranë gjykatave të rretheve

1. Ndihmës gjyqtarë	26 400 lekë

PASQYRA 4

4. PAGAT E INSPEKTORIATIT PRANË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

4.1. Kryeinspektor dhe inspektor pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë

1. Kryeinspektor	62 040 lekë
2. Zëvendëskryeinspektor	52 580 lekë
3. Inspektor	49 500 lekë